

Kushtet e Përdorimit

Ky dokument përbën një marrëveshje të lidhur midis **Clima Point Albania Shpk**, e regjistruar pranë QKB me NIPT **M02312009T**, me seli në adresën: Rruga Egnatia, Tirana Industrial Park, Magazina Nr.17, Kashar, Tirana, Albania, dhe përdoruesve përkatës të platformes **Zona Profesionale**, e cila parashikon Kushtet e Përdorimit të dokumentave apo materialeve të **Clima Point Albania** dhe **Mitsubishi Electric** nëpërmjet faqes së internetit <https://climapoint.al/zona-profesionale/> (në vijim referuar si "Kushtet e Përdorimit").

Duke u bërë pjesë e kësaj platforme, ju bini dakord që të mos ndryshoni në asnjëlloji formë apo mënyrë asgjë nga dokumentat apo materialet, si dhe të mos shpërndani në palë të treta të paautorizuara dokumenta, materiale apo informacione që ndodhen përkatësisht në faqen e internetit <https://climapoint.al/zona-profesionale/>.

Ju pranoni dhe bini dakord që materiale e disponueshme në këtë faqe interneti mbrohen nga e drejta e autorit, marka tregtare, emri i domenit, markat e shërbimit, patentat, sekretet tregtare ose të drejta dhe ligje të tjera të pronësisë intelektuale. Përveç rasteve të autorizuara shprehimisht nga Clima Point Albania ose Mitsubishi Electric Corporation. Ju pranoni të mos shisni, licenconi, modifikoni, shpërndani, kopjoni, riprodhoni, transmetoni, shfaqni publikisht, publikoni, përshtatni, modifikoni ose krijoni vepra të tjera të prejardhura me **materialet**.

Të gjitha privilegjet e të drejtave të autorit janë të rezervuara.

"MITSUBISHI" është një markë e regjistruar tregtare dhe nuk lejohet përdorimi i saj, dhe as nuk jepet ndonjë licencë për përdorimin e një marke të tillë tregtare nga përdorimi juaj në këtë faqe.

"Clima Point Albania" është një markë e regjistruar tregtare dhe nuk lejohet përdorimi i saj, dhe as nuk jepet ndonjë licencë për përdorimin e një marke të tillë tregtare nga përdorimi juaj në këtë faqe.

Ju pranoni se titulli, pronësia dhe të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale në dhe ndaj materiale dhe çdo kopje e materialeve janë në pronësi dhe mbeten me Mitsubishi Electric Corporation ose filialet e saj dhe kompanitë e lidhura, përveç nëse specifikohet ndryshe. Materialet mund të ndryshohen, përmirësohen ose përditësohen periodikisht në çdo kohë pa paralajmërim. Për të marrë informacionin më të fundit të produktit, fletët e të dhënave, informacionin teknik ose detaje të mëtejshme rreth ndonjë prej materialeve në këtë faqe, ju mund të na kontaktoni.

Kushtet e Përdorimit zbatohen për të gjithë materialet në faqes e internetit të **Clima Point Albania**.

Në rast ndryshimi të Kushtet e Përdorimit, ndryshimet përkatëse do të publikohen në këtë faqe interneti.

Në rast ndryshimesh, ato nuk do të kenë fuqi prapavepruese.

Clima Point Albania nuk mban përgjegjësi nëse gjatë navigimit në këtë faqe interneti mund të shkarkohen materiale të padëshirueshme apo të pakonfirmuara nga përdoruesi. Gjithashtu, **Clima Point Albania** nuk është përgjegjës për probleme që mund të lindin për shkak të mungesës së antivirusit, firewall-it apo browser të papërditësuar në pajisjet e përdoruesit gjatë hyrjes në faqen e **Clima Point Albania**.

Përdoruesi merr vetë përsipër të përdorë pajisjet dhe programet e duhura për t'u mbrojtur nga sulme të jashtme (viruse, site të ndryshme etj.).

Clima Point Albania mund të vendosë në çdo kohë të pezullojë, ndryshojë apo përfundojë ofrimin e këtij shërbimi në rrugë elektronike për shkak të punimeve të mirëmbajtjes, për të përditësuar ose përmirësuar faqen ose për çfarëdo arsye tjetër.

Shkelja e këtyre kushteve i jep të drejtë **Clima Point Albania** t'iu heqë aksesin nga faqja/platforma e Zones Profesionale për këto arsye apo çfarëdo tjetër.